


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5504
E martë, 19 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Franca përkrah Kosovën për liberalizimin e vizave

Kryeparlamentari Kadri Veseli është takuar me presidentin e Asamblesë Kombëtare të Francës, François de Rugy, me të cilin ka diskutuar për vazhdimin e mbështetjes së Francës për Kosovën, në mënyrë të veçantë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe për liberalizimin e vizave



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ME NDERIME TË LARTA SHETËRORE ËSHTË VARROSUR TË HËNËN NË GLLOGJAN VEPRIMTARI DHE LIRIDASHËSI HILMI HARADINAJ

Kosova i jep lamtumirën e fundit atdhetarit Hilmi Haradinaj



Babait të kryeministrit Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinajt, të hënën i është dhënë lamtumira e fundit me nderime të larta shtetërore. Në ceremoninë e varrimit në Gllogjan kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë nga

Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, përfaqësues të partive politike, deputetë, ministra, kryetarë komunalash, si dhe mijëra qytetarë. Figura e babait të dy dëshmorëve të kombit dhe katër gjeneralëve të UÇK-së është

vlerësuar lart nga të pranishmit. Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi për të ndjerin Hilmi Haradinaj ka ndarë Medaljen Presidenciale Jubilarë të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë

KOSOVA DHE SERBIA NUK MUND TË DIALOGOJNË PAFUNDËSISHT

Kërkohet afatizim për fazën finale të dialogut

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se Kosova dhe Serbia nuk mund të negociojnë pa kufi për procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre. Ata kanë

kërkuar që të caktohen afatet kohore brenda të cilëve do të diskutohen për fazën finale të këtij procesi. Vigan Qorrolli dhe Ramush Tahiri, ndonëse kanë shprehur mendime të ndryshme

se kur mund të arrihet traktati i paqes në mes të dy shteteve, kanë deklaruar se marrëveshjet që nënshkruhen në këtë proces duhet të zbatohen nga palët në përpikëri

AKTUALE

SOFRAT TONA JANË MBUSHUR ME PRODUKTE TË DYSHIMTA F. 11

Nga Shemsi SYLA



KOMISIONI HETIMOR PRITET TA JAPË EPILOGUN PËR DËBIMIN E SHTETASVE TURO F. 6

SALLAT E OPERACIONIT NË OKUK PO PUNOJNË ME KAPACITET TË PLOTË F. 6

VETËVENDOSJA KËRKON QË PRESIDENCA T'I EMËROJË DY ANËTARË TË VET NË KOZ F. 7

EKONOMI

KËRKOHEM QË 'TREPÇËS' T'I HAPET RRUGA E ZHVILLIMIT EKONOMIK F. 9

PAPUNËSIA NË TREMUJORIN E PARË, 26.5 PËR QIND F. 8

KULTURË

POEZI NGA EMINE MALIQI-ZAIRI F. 8



SPORT

SALIHU: LOGOJA E FFK-së ËSHTË UNIKE F. 21

MEDIET BRAZILIANE SULMOJNË ASHPËR NEYMARIN F. 21

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bushati takohet me Kotziasin këtë javë

TIRANË, 18 QERSHOR - Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati dhe homologu i tij grek, Nikos Kotzias, do të takohen këtë javë në vijim të negociatave mes Shqipërisë dhe Greqisë. Lajmin e bëri me dije Bushati, të hënën në Berat, ku tha se do të ketë takim mes grupeve negociatore. "Kësaj jave do të ketë një takim tjetër me homologun Kotzias, ku do ta vazhdojmë diskutimin e gjetjes së një marrëveshjeje për delimitimin e zonave detare dhe besoj se para-

lelisht me takimin tonë do të ketë edhe një takim tjetër të ekipit negociator. Është një proces që ka hyrë në një fazë të pakthyeshme, por shpresoj se të dyja palët kanë nevojë për një kohë që të shkojnë drejt një marrëveshjeje të pranueshme dhe të drejtë dhe mbi një marrëveshjeje që do të jetë e zbatueshme", u shpreh Bushati. Ai deklaroi se negociatat nuk do të ndërpriten dhe se ekipet janë me kapacitet të plotë. I pyetur nëse i janë dhënë të gjitha

informacionet e kërkuara presidentit Ilir Meta, Bushati tha se pas çdo raundi diskutimesh presidenti i është vënë në dispozicion problematika e çështjeve të diskutuara. "Mbi bazën e Kushtetutës është presidenti ai që lëshon autorizimin, prandaj është e kuptueshme çdo kërkesë e tij", tha ministri. Raundi i parë i bisedimeve midis Greqisë dhe Shqipërisë mbi zonat detare të kufirit u mbajt më 30 prill 2018 në Tiranë.



Franca përkrah Kosovën për liberalizimin e vizave

Kryeparlamentari Kadri Veseli është takuar me presidentin e Asamblesë Kombëtare të Francës, François de Rugy, me të cilin ka diskutuar për vazhdimin e mbështetjes së Francës për Kosovën, në mënyrë të veçantë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe për liberalizimin e vizave

vendimin e madh për liberalizimin e vizave", tha kryeparlamentari Veseli.

Kreu i Kuvendit të Kosovës tha se pas plotësimit të të gjitha kriterëve të parapara, synimi është që këtë vit ta kemi liberalizimin e vizave për qytetarët, për të rinjtë, intelektualët, akademikët, ndërmarrësit, në mënyrë që qytetarët e Kosovës ta ndiejnë veten të barabartë me qytetarët e vendeve të tjera. "Dhe kjo do të ndodhë. Jemi

duke e bërë bashkërisht këtë përpjekje, pozitë dhe opozitë. Falënderoj deputetët nga të gjitha grupimet politike dhe etnike. Kjo është një pasqyrë e mirë e shtetit tonë, pas gjithë asaj çfarë kemi kaluar në tre vjetët e kaluar", theksoi kryeparlamentari Veseli.

Kryetari Veseli dhe anëtarët e delegacionit e njoftuan hollësisht De Rugy për përparimin që Kosova ka bërë në rrugën eurointegruese, veçanërisht

aktivitetin legjislativ intensiv, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian për institucionet e Kosovës.

Presidenti i Asamblesë Kombëtare të Francës, François de Rugy, duke vlerësuar progresin që ka shënuar Kosova në përmbushjen e detyrave të cilat i kërkohen në procesin e integritit evropian, konfirmoi mbështetjen franceze për Kosovën edhe në të ardhmen.

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në krye të një delegacioni të përbërë nga përfaqësues të pozitës dhe të opozitës, ka nisur vizitën zyrtare në Francë me pritjen nga presidenti i Asamblesë Kombëtare të Francës, François de Rugy. Në takim me homologun francez, kryeparlamentari Veseli diskutoi për bashkëpunimin midis Kosovës dhe Francës në të gjitha fushat, si dhe për zgjerimin e marrëdhënieve ndërmjet dy parlamentare.

Gjatë takimit kryeparlamentari Veseli shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Francës për të gjitha proceset e deritashme në Kosovë, ndërsa kërkoi vazhdimin e përkrahjes së Parisit zyrtar, sidomos tani për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës gjatë këtij viti. "Franca është një nga aleatët tanë në rrugëtimin tonë euroatlantik. Ne presim përkrahjen e këtij shteti të lirisë dhe pavarësisë. Morëm zotimin për përkrahje, në mënyrë të veçantë për integrimin e Kosovës në BE

dhe natyrisht për liberalizimin e vizave, i cili është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Jam i lumtur që do ta kemi përkrahjen e Francës në fushën parlamentare, lidhur me



Zëvendëskryeministri i Maqedonisë, Osmani, sot në Kosovë

SHKUP, 18 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i Republikës së Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, sot (e martë) do të qëndrojë në Republikën Kosovë në vizitë njëditore, ku do të realizojë takime me

presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Enver Hoxhaj. Sipas njoftimit të Qeverisë së Maqedonisë, në këto takime do të hapen temat e avancimit të bashkëpunimit të

ndërsjellë mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, pritet nga samitet e ardhshme të Bashkimit Evropian, si dhe në përgjithësi, perspektivat evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor.



Kosova dhe Serbia nuk mund të dialogojnë pafundësisht

Kërkohet afatizim për fazën finale të dialogut



Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se Kosova dhe Serbia nuk mund të negociojnë pa kufi për procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre. Ata kanë kërkuar që të caktohen afatet kohore brenda të cilëve do të diskutohen për fazën finale të këtij procesi. Vigan Qorrolli dhe Ramush Tahiri, ndonëse kanë shprehur mendime të ndryshme se kur mund të arrihet traktati i paqes në mes të dy shteteve, kanë deklaruar se marrëveshjet që nënshkruhen në këtë proces duhet të zbatohen nga palët në përpikëri

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë kërkuar që të afatizohet procesi i dialogut për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndonëse kanë shprehur pikëpamje të ndryshme rreth arritjes së traktit të paqes në mes të dy vendeve, ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se asnjëra palë nuk mund t'u ikë obligimeve ndërkombëtare në këtë proces.

Juristi dhe ligjëruesi në Universitetin e Prishtinës, Vigan Qorrolli, ka deklaruar se afatizimi i dialogut është çelësi i

suksesit të këtij procesi. "Së pari, dialogu Prishtinë - Beograd nuk mund të vazhdojë pafundësisht, pra duhet të ketë një pajtim paraprak për prioritetet dhe afate, gjë që me këtë format aktual nuk i ka asnjërin. Afatizimi i dialogut është çelësi i suksesit të tij. Nuk mund të negociohet pa kufi. Nëse qëllimi final i BE-së është traktati i paqes, pra pajtimi midis dy popujve e dy shteteve, atëherë ajo duhet t'i vë afat këtij dialogu se kur duhet të ndodhë ai pajtim", ka thënë Qorrolli, duke shtuar se palët duhet t'i zbatojnë marrëveshjet që i nënshkruajnë në Bruksel. "Së dyti, dialogu ka nevojë për disiplinë mes palëve dhe kjo

nënkupton që marrëveshjet e arritura deri më tash ose duhet të zbatohen 100 %, ose nuk duhet të nënshkruhen fare vetëm sa për sy e faqe. Një marrëveshje ose zbatohet plotësisht, sepse nuk ka asnjë logjikë në marrëdhëniet ndërkombëtare që një marrëveshje bilaterale të zbatohet pjesërisht, ose të mos zbatohet fare. Kjo duhet të marrë fund njëherë e mirë", është shprehur Qorrolli. Ndërsa politologu Ramush Tahiri ka thënë për gazetën se arritja e një trakti të paqes mes dy vendeve nuk është shumë urgjente. Sipas tij, urgjent është normalizimi i raporteve në mes të dy shteteve. "Nuk pres që kjo fazë e dialogut të përmbyllet aq shpejt. Një konflikt që, siç thotë Vuçiqi, ka zgjatur 140 vjet mes shqiptarëve dhe serbëve, nuk pret askush që mund të zgjidhet për nëntë muaj. Asnjë konflikt apo luftë që ka zgjatur kaq shumë nuk mund të zgjidhet brenda kësaj prridhe. Kjo është më shumë ndonjë deklaram politik, sepse nuk mund të bëhet për 9 muaj ndonjë marrëveshje e paqes mes shqiptarëve dhe serbëve", ka thënë Tahiri.

Ai ka bërë me dije se Kosova nuk duhet të ngutet për arritjen

e kësaj marrëveshje. "Unë këtë nuk e shoh si çështje shumë urgjente. Për mua normalizimi i raporteve është me rëndësi, sepse Evropa është e interesuar për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve dhe raporte konkrete të fqinjësisë së mirë. Nuk ka ndonjë arsye të fortë që Kosova të ngutet të nënshkruajë ndonjë marrëveshje paqeje me Serbinë, sepse marrëveshjet e paqes janë një sërë konditash", ka thënë ai. Madje, sipas Tahirit, traktati i paqes në mes të dy vendeve do të duhet t'u lihet gjeneratave të ardhshme, të cilat janë më pak të ngarkuara me historinë e raporteve midis dy popujve. "Arritja e një marrëveshje të paqes në mes të dy vendeve është një çështje më e madhe, që për momentin mendoj se nuk kanë kapacitete as Serbia dhe as Kosova ta nënshkruajnë. Këto gjenerata nuk duhet të bisedojnë për këtë çështje sepse kanë paragjykime nga e kaluara. Kjo çështje nuk është pengesë as për Kosovën e as për Serbinë. Të dy vendet mund të zhvillojnë marrëdhënie normale ndërkombëtare në mënyrë që këto çështje të lihen për gjeneratat e ardhshme, të cilat nuk janë të ndikuara nga e

kaluara dhe të cilat kanë zgjidhje më të mirë sesa gjeneratat e tashme. Sepse gjeneratat e tashme në një farë forme janë të shantazhuara, për dallim nga gjeneratat e ardhshme që nuk do të jenë. Pra, nuk shoh ndonjë urgjencë për bisedime politike mes Serbisë dhe Kosovës", ka thënë Tahiri.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili pritet ta udhëheqë delegacionin e Kosovës në fazën finale të këtij procesi, ka paralajmëruar se faza finale e dialogut me Serbinë do të jetë jashtëzakonisht e vështirë dhe me komplikime. Në një konferencë me gazetarë, pas kthimit nga Samiti i Sofjes, ai pati bërë me dije se kjo fazë e dialogut mund të përmbyllet brenda nëntë muajve. "Do të fillojë pas disa javësh dhe jam optimist se brenda një periudhe nëntëmuajore do të përmbyllet si marrëveshje. Po them përsëri se do të jetë një proces jashtëzakonisht i vështirë, me plot komplikime. Mund të ketë edhe të panjohura, por nuk besoj se do të ketë befasi. Shpresë dhe optimizëm në këtë proces mua më jep përfshirja e fuqishme dhe unike e BE-së dhe mbështetja e ShBA-së", kishte thënë Thaçi.

Me nderime të larta shtetërore është varrosur të hënën në Glllogjan veprimtari dhe lirishtetësi Hilmi Haradinaj

Kosova i jep lamtumirën e fun

Babait të kryeministrit Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinajt, të hënën i është dhënë lamtumira e fundit me nderime të larta shtetërore. Në ceremoninë e varrimit në Glllogjan kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, përfaqësues të partive politike, deputetë, ministra, kryetarë komunash, si dhe mijëra qytetarë. Figura e babait të dy dëshmorëve të kombit dhe katër gjeneralëve të UÇK-së është vlerësuar lart nga të pranishmit. Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi për të ndjerin Hilmi Haradinaj ka ndarë Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë

EPOKA E SHQIPE HETEMI

GLLOGJAN, 18 QERSHOR - Me nderime të larta shtetërore të hënën në Glllogjan të Deçanit i është dhënë lamtumira e fundit babait të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinajt. Të pranishëm në ceremoninë e varrimit kanë qenë zyrtarë të lartë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia, përfaqësues të partive politike, deputetë, ministra, kryetarë të komunave si dhe mijëra qytetarë. Me këtë rast, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se lajmi për vdekjen e Hilmi Haradinajt ishte i dhimbshëm për familjen dhe të gjithë ne. Ai ka thënë se Hilmi Haradinaj gjatë gjithë jetës së tij ka treguar urtësi, maturi dhe vendosmëri të lartë patriotike, duke u bërë kështu emblemë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Bacën Hilmi e njoha qysh në fillimet e para të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dukagjin, në pranverë të 1996-s. Më herët, përmes Kadri Veselit, e kisha takuar Luanin. Me Luanin dhe Kadriun kalonim kufirin Shqipëri - Kosovë, deri në rënien heroike të Luanit. Gjithmonë nga udhëtimi i gjatë dhe rraskapitës, në dimër dhe verë, me të hyrë në Kosovë, me ne ishte dhe Shkëlzeni, për t'u strehuar tek baca Hilmi dhe për të vazhduar tutje në Jabllanicë.

Baca Hilmi gjithmonë tregonte urtësi, maturi dhe vendosmëri të lartë patriotike. Ishte ndër pjesëtarët e bërthamave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithmonë vazhdonte me këshillat e mençura dhe atërore për të gjithë ne, para, gjatë dhe pas luftës. Nuk kishte si të mos ndodhte kështu, sepse Ismail Haradinaj qysh herët ishte ndër udhëheqësit e lëvizjes kombëtare për kauzën e Republikës së Kosovës", është shprehur presidenti Thaçi. Duke iu drejtuar familjes Haradinaj, kreu i shtetit ka thënë se ata humbën një bashkëshort, një baba dhe një gjysh të jashtëzakonshëm, kurse Kosova dhe populli i saj ka mbetur pa një veteran, pa një bashkëluftëtar dhe pa një njeri me zemër të madhe atdhetare. Ai ka theksuar se baca Hilmi ishte një burrë i dëshmuar dhe i sprovuar në ditët më të vështira të Kosovës. "Baca Hilmi nuk u dorëzua as përballë sfidave jo të lehta edhe në kohën e pasluftës. Ai me dinjitet dhe qetësi përballoi padrejtësitë e burgosjeve të të bijve. Të gjitha goditjet e jetës i përballoi faqebardhë. Ishte njeri me vlera të thella, i urtë, modest. Burrë i Dukagjinit dhe Kosovës", ka thënë Thaçi, duke shtuar se baca Hilmi vdiq në muajin qershor, kur anembanë Kosovës po shënohet 19-vjetori i çlirimit. Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti



Thaçi për të ndjerin Hilmi Haradinaj ka ndarë Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë. Ndërsa në emër të familjes së komandantit legjendar, Adem Jashari, familjen Haradinaj e ka ngushëlluar Rifat Jashari. "E nderuar familje Haradinaj, pranoi ngushëllimet e mia dhe të familjes sime. Bacën Hilmi inshallah Zoti e ka marrë në rahmetin e vet dhe inshallah Zoti na takon në xhenet! Lavdi dhe nder Hilmi Haradinajt dhe të gjithë të rënëve", ka thënë Jashari. Të pranishmit me një fjalë rasti i ka përshëndetur edhe kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, i cili ka thënë se Hilmi Haradinaj do të jetë gjithmonë në kujtesën e historisë

së popullit shqiptar. Ai ka shtuar se baca Hilmi ka qenë njeri fjalëpakë, punëtor i palodhshëm dhe atdhetar. "Po ndahemi fizikisht nga baca Hilmi, por shpirtërisht do të jetë gjithmonë në kujtesën tonë dhe në kujtesën e historisë më të re të kombit shqiptar, njeriu fjalëpakë, punëtor dhe i palodhshëm. Do të mbetet në kujtesën e çdo ushtari i cili u pajis me bukë e barut në kullën e axhë Hilmiut. Lavdi për jetë të jetëve, Hilmi Haradinajt!", ka deklaruar Ahmeti. Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, (PD) Lulzim Basha, ka vlerësuar lart personalitetin e Hilmi Haradinajt. Ai ka pohuar se baca Hilmi i ka dhënë kombit shqiptar cilësi të jashtëzakonshme të qëndrësës, vendosmërisë dhe patriotizmit. "Kam ar-

hur për ta ndarë dhimbjen dhe respektin e thellë me familjen Haradinaj që kaq shumë i ka dhënë Kosovës dhe kombit shqiptar. Por, nuk kam ardhur të ndahem me bacën Hilmi. Kam ardhur siç keni ardhur të gjithë ju këtu, për ta nderuar burrin që i dha karakterit të shqiptarëve cilësi të jashtëzakonshme të qëndrësës, vendosmërisë dhe patriotizmit. Kam ardhur për ta nderuar atdhetarin e pavdekshëm. U prehsh në paqe me zotin, baca Hilmi!", ka thënë Basha. Ndërsa kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se Hilmi Haradinaj ishte luftëtar i tipik dhe i palëkundur përballë stuhive që rënduan mbi të dhe familjen e tij, prandaj do të përkujtohet gjithmonë me nder



Lavdi atdhetarit Hilmi Haradinaj

dhe burrërisë. "Familja Haradinaj në të gjitha periudhat e historisë sonë ishte sinonim i familjes që nuk u pajtua dhe nuk u dorëzua, por ngrehi zërin kryengritës për lirinë dhe pavarësinë e kombit, pavarësisht prej çmimit që do të paguanin. Hilmi Haradinaj dhe familja e tij me gjak e shkroi emrin e lirisë. Baca Hilmi nuk thyhej. Ai qëndroi si lis i madh mes furtunash. Hilmi Haradinaj ishte shembull i qëndrësës dhe burrërisë. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Lavdi jetës dhe veprës së Hilmi Haradinajt!", ka theksuar Doda.

Kurse në emër të familjes Haradinaj

vështirë ne familja, e kemi të vështirë bashkëluftëtarët dhe kushdo që e çmon lirinë, që po ndahemi prej një luftëtari të shquar për lirinë tonë, të shqiptarëve dhe të gjithëve që bashkëtojnë me shqiptarë. Liria e Kosovës është rezultat i shumë mundjeve dhe sfidave. Pra, edhe përmes ndihmave të aleatëve tanë, nga NATO dhe ShBA-ja e nga vendet e tjera liridashëse. Porosia ime është t'i mbetemi besnikë lirisë ashtu siç ishte besnik për të drejtën e shqiptarëve dhe për lirinë tonë babai ynë, Hilmiu. U prehsh në paqe, plak!", ka



dhe lavdi. "Është e zorshme të gjenden fjalët për ta përshkruar bacën Hilmi. Ai ishte luftëtari më tipik dhe i palëkundur përballë stuhive që rënduan mbi të dhe familjen e tij. Ai i dha këtij vendi tre heronj dhe katër gjeneralë. Baca Hilmi, ti ishe luftëtar i madh, burrë dhe atdhetar me virtyte të larta. Me ndër e më lavdi jetove, me nder dhe me lavdi do të përkujtohet emri yt për breza të tërë që do të vijnë në këtë truall. Lamtumirë përfaqësuesi më i mirë i burrërisë shqiptare! I përjetshëm qoftë kujtimi për ty", është shprehur Ramosaj.

Në emër të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, Faik Doda ka folur për kontributin e Hilmi Haradinajt dhe familjes së tij në luftën për çlirimin e vendit. Ai ka thënë se baca Hilmi ishte shembull i qëndrësës



të pranishmit i ka përshëndetur i biri i Hilmi Haradinajt, kryeministri Ramush Haradinaj. Me këtë rast, ai ka thënë se do të jetë e vështirë për të gjithë për ta përballuar humbjen e Hilmi Haradinajt. "E kemi të

deklaruar Haradinaj. Babai i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinaj, ka ndërruar jetë në mbrëmjen e së shtunës, pas një sëmundjeje të rëndë.



Kori diplomatik në Australi mban pritje lamtumirëse për nder të ambasadorit Kiçmari

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Me ftesë të dekanit të Korit Diplomantik në Australi, ambasadorit Abel Guterres, shefat e misioneve diplomatike në Australi kanë mbajtur një takim lamtumirës në Kanbera për nder të ambasadorit të Republikës së Kosovës, Sabri Kiçmari.

Dekani i Korit Diplomantik, Abel Guterres, ka falënderuar ambasadorin Kiçmari për rolin e tij në thellimin e marrëdhënies me Republikën e Australisë dhe vendet e Paqësorit si ambasadori i parë i Republikës së Kosovës në Australi dhe në rajon, për praninë e ndjeshme në radhët e Korit Diplomantik dhe profesionalizmin e tij gjatë kohës së shërbimit të tij. Në fjalën e tij ambasadori i Republikës së Kosovës, Sabri Kiçmari, e ka falënderuar dekanin e Korit Diplomantik, ambasadorin Guterres, për nderimin, duke i ftuar në takim lamtumirës shefat e misioneve diplomatike. "Pas katër vjetësh e shtatë muajsh po ndahem nga ju. Nëse më pyesni si ndihem, mund t'ju përgjigjem se rrallë kam pasur ndjenja kaq të përziera, ndoshta ambivalente, kundërthënëse me njëra-tjetrën: në njërin anë jam i mërzhitur, në anën tjetër i gëzuar. I mërzhitur sepse do të largohem nga ky vend kaq i bukur, nga ky qytet i qetë, me klimë shumë të mirë, pa dimër, pra unë nuk e dua dimrin dhe të ftohtët, dhe po ndahem nga ju



miq të nderuar, ambasadorë dhe shefa misionesh, po ndahem nga miqtë e mi nga Ministria e Jashtme e Australisë, dhe nga ky rajon i mrekullueshëm i Paqësorit. I gëzuar sepse po kthehem në vendin tim, në Republikën tonë të re, aromën e së cilës nuk e përjetojva gjatë, sepse pak kohë pasi u shpall Republika e Kosovës, unë u nisa në detyrë për ta përfaqësuar atë në Austri për pesë vjet e një muaj dhe këtu në Australi për katër vjet e shtatë muaj e gjysmë", ka thënë Kiçmari.

Ambasadori Kiçmari ka falënderuar Qeverinë e Australisë për mbështetjen permanente të Kosovës: pranimin e 4 000 refugjatëve nga Kosova gjatë luftës në vitin 1999, për rolin e ushtarëve australianë në krijimin e paqes në Kosovë, për njohjen e Republikës së Kosovës vetëm dy ditë pas shpalljes, për votën pro pranimin të Republikës së Kosovës në


Fondin Monetar Ndërkombëtar, për Bankën Botërore, UNESCO-n dhe në një numër të madh organizatash ndërkombëtare.

Ai ka theksuar më tutje se kthehet në Kosovë me një përvojë të jashtëzakonshme: "I kam vizituar të tetë kryeqytetet e shteteve australiane, e kam vizituar shpesh Zelandën e Re, Ishujt Solomon, Fihin, Vanuatun, Samoan, Ishujt Kok, madje edhe Indonezinë dhe Timorin Lindor. Gjatë qëndrimit tim këtu kam pasur nderin që në emër të Republikës së Kosovës të negocioj dhe nënshkruaj pesë marrëveshje ndërshtetërore me vendet e paqësorit, marrëveshje të tjera janë në proces negociimi, e kemi përmbyllur procesin e njohjes në këtë pjesë të globit dhe kam takuar një numër ministrash të jashtëm, kryeministrash e shefash shtetesh. Dua ta shpreh falënderimin tim të sinqertë për të gjithë shefat e misioneve nga këto

vende, të cilët më kanë mbështetur gjatë misionit tim këtu", është shprehur ai.

Dekani i Korit Diplomantik i ka dorëzuar ambasadorit Kiçmari mirënjohjen e Korit Diplomantik në Australi me përkushtimin e mëposhtëm: "Kori Diplomantik në Australi dëshiron të nderojë për shërbimin e tij Shkëlqesinë e Tij, dr. Sabri Kiçmari, Ambasador i Republikës së Kosovës 2013-2018. Kori Diplomantik e uron

Shkëlqesinë e Tij për misionin e tij të suksesshëm dhe i dëshiron atij dhe familjes së tij fat në angazhimet e tij në të ardhmen". Gjatë pritjes ambasadori Kiçmari ka zhvilluar takime me të gjithë ambasadorët dhe shefat e misioneve diplomatike që ishin të pranishëm. Në pritje kanë marrë pjesë edhe një numër i madh i shefave të misioneve diplomatike nga vendet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.



Sallat e operacionit në QKUK po punojnë me kapacitet të plotë

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Zyra e drejtorit të përgjithshëm e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar e Kosovës (ShSKUK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se të gjitha sallat e operacionit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), përfshirë edhe Klinikën e Urologjisë, kanë punuar dhe po punojnë me kapacitete të plota, pas furnizimit me sasi të bollshme të anestetikëve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

"Bazuar në informatat nga Drejtoria e Klinikës së Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv, por edhe nga Drejtoria e Klinikës së Urologjisë, të gjitha sallat e operacionit kanë punuar me kapacitet të plotë", është theksuar në komunikatën e ShSKUK-së. Sipas kësaj komunikate, protokollet-evidencat e sallave të operacionit në urologji vërtetojnë se janë kryer të gjitha operacionet e planifikuar dhe ato urgjente. "Vetëm në dy javët e kaluar janë kryer 39



operacione me anestezion të përgjithshëm dhe nuk ka dësh-

tuar asnjë operacion. Po ashtu, Barnatorja Qendrore QKUK-

ShSKUK konfirmon se të gjitha klinikat dhe spitalet e përgjithshme janë të mbuluar për tre muajt e ardhshëm në sasi të mjaftueshme me anestetikë të nevojshëm për sallat e operacionit. QKUK-ShSKUK siguron të gjithë qytetarët që kanë nevojë, se sallat janë në funksion të plotë dhe këtë shërbim mund të marrin në çdo kohë në klinikat dhe spitalet përkatëse që janë në kuadër të ShSKUK-së", është thënë komunikatën e ShSKUK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë emëron koordinator për rastet e gazetarëve

Prishtinë, 18 qershor (ER) - Kryetarja e Gjykatës Themelore të Prishtinës, Afërdita Bytyçi, ka emëruar gjyqtarin Arben Hoti, koordinator të kësaj gjykate për rastet e medieve dhe të gazetarëve. "Ju njoftoj se për rastet e medieve dhe të gaze-

tarëve që trajtohen në Gjykatën Themelore të Prishtinës kemi emëruar koordinator gjyqtarin - nënkryetarin e Gjykatës, Arben Hoti. Andaj për çdo rast (lëndë) që trajtohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe degëve të saj

mund ta kontaktoni gjyqtarin Hoti", ka thënë Bytyçi. Emërimi i gjyqtarit Arben Hoti, si koordinatori për rastet e medieve dhe gazetarëve, vjen pas një takimi të zhvilluar ditë më parë ndërmjet përfaqësuesve të Asociacionit të Gazetarëve të

Kosovës (AGK) me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizin dhe kryetaren e Gjykatës Themelore të Prishtinës, Afërdita Bytyçin, me ç'rast u është dorëzuar kërkesa zyrtare për emërimin e një koordinatori në Gjykatën

Themelore të Prishtinës, duke e parë kështu ngarkesën e madhe të cilën e ka kjo gjykatë me lëndët e medieve dhe gazetarëve. AGK-ja ka mirëpritur emërimin e koordinatorit Hoti në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Vetëvendosja kërkon që Presidenca t'i emërojë dy anëtarë të vet në KQZ

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka thënë se është e drejtë e subjekteve politike që në bazë të fuqisë së marrë në zgjedhjet e fundit t'i dërgojë anëtarët e vet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Ajo ka thënë se Vetëvendosja duhet t'i ketë dy anëtarë të vet në KQZ

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të hënën konferencë për medie, në të cilën kanë folur për vonesat në lidhje me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga ana e presidentit Hashim Thaçi. Përfaqësuesit e këtij subjekti politik i kanë quajtur veprime jokushtetuese emërimet e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga zyra e presidentit, që ende nuk janë publikuar për opinionin.

Nazlie Bala nga LV-ja ka treguar për thirrjen krejtësisht në mënyrë joserioze, pa asnjë shkresë apo e-mail zyrtar që ajo ka marrë nga zyra e presidentit. "Të enjten e kaluar, nga zyra e presidentit, gjegjësisht nga zyra ligjore, kam pranuar një telefonatë për të marrë pjesë në betimin si anëtare e KQZ-së. Kjo thirrje nuk është as zyrtare e as ligjore sepse nuk kam pranuar asnjë dokument zyrtar, aq më tepër kur i nominuari tjetër nga Lëvizja, Adnan Rustemi, nuk është kontaktuar fare. Kjo ka ndodhur pa asnjë shpjegim zyrtar dhe kështu është e papranueshme", ka thënë Nazlie Bala. Ajo ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje duhet t'i ketë dy anëtarë në KQZ, sikurse edhe LDK-ja duhet t'i ketë dy anëtarë.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu,

ka thënë se është e drejtë e subjekteve politike që në bazë të fuqisë së marrë në zgjedhjet e fundit t'i dërgojnë anëtarët e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. "Në KQZ duhet t'i ketë dy anëtarë koalicioni PAN, dy anëtarë Lëvizja Vetëvendosje

dhe dy anëtarë LAA siç e kërkon Kushtetuta dhe Ligji për Zgjedhje, dhe siç e përcaktoi rezultati i zgjedhjeve të 11 qershorit 2017. Përkundër që Presidenca nuk inicioi procedurën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje më 17 prill të këtij viti dorëzoi dy nominimet, Adnan Rustemin dhe Nazlie Balajn, për dy anëtarë në KQZ, ashtu siç parashikohet me Kushtetutë dhe Ligjin për Zgjedhje", ka thënë Albulena Haxhiu. Përfaqësuesit e LV-së kanë theksuar se aktualisht zyra e presidentit në vend se të proce-

dojë me këto nominime, po pengon emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga opozita. Adnan Rustemi ka konstatuar se ndonëse kanë kaluar mbi dy muaj prej kur Lëvizja Vetëvendosje ka dërguar dy nominimet e saj për anëtarë të KQZ-së, Presidenca nuk i ka përmbushur përgjegjësitë që kanë në konfirmimin e këtyre nominimeve si anëtarë të KQZ-së. "Në bazë të Ligjit për Zgjedhje mandati i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të

zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës. Gjersa rezultati i zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës është certifikuar më 8 korrik dhe sipas ligjit do të duhej që përbërja e KQZ-së të ndryshonte më së largu deri në fillim të shtatorit të vitit të kaluar, duke reflektuar kështu përbërjen e re në bazë të rezultatit të zgjedhjeve të 11 qershorit", ka thënë Adnan Rustemi.

Ndërkaq përfaqësuesit e LV-së kanë kërkuar nga zyra e presidentit që pa vonesa të mëtejshme të konfirmohen të dy anëtarët e KQZ-së që do ta përfaqësojnë Lëvizjen Vetëvendosje.



Komisioni hetimor pritet ta japë epilogun për dëbimin e shtetasve turq

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Komisioni hetimor parlamentar do ta thotë fjalën e fundit lidhur me dëbimin e shtetasve turq, duke sqaruar të gjitha rrethanat e kësaj ngjarjeje. Kështu ka bërë me dije zëvendëskryetarja e parë e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës, Ganimete Musliu, pas takimit ku raportoi drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Shpend Maxhuni. "Ditët e fundit është themeluar një komision



parlamentar hetimor. Deri në epilogun që do të japë ai komision nuk mund të themi asgjë. Komisioni e ka marrë aprovimin e Kuvendit për të hulumtuar këtë rast", ka thënë Musliu. Kuvendi i Kosovës më 17 prill ka miratuar një rezolutë për themelimin e një komisioni hetimor lidhur me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Më 29 mars, me kërkesë të autoriteteve turke, Policia e Kosovës ka arrestuar dhe dëbuar

për në Turqi gjashtë qytetarë turq, pesë prej tyre punonjës në shkollën "Mehmet Akif", ndërsa i dëbuar i gjashtë mjek. Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Shpend Maxhuni, ka raportuar të hënën para Komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e këtij mekanizimi. Musliu ka thënë se gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për gjendjen e sigurisë në Kosovë, e cila është vlerësuar të jetë e qetë dhe stabile.

OEK-u: Nevojë urgjente, markimi për produktet e ndërtimit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka ftuar kompanitë e produkteve të ndërtimit që të punojnë më tepër për posedim të markës CE për produktet e tyre. Sipas OEK-ut, markimi CE përmban disa informacione thelbësore rreth produktit dhe siguron një lidhje me dokumentet e tjera shtesë të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme. "Vlera e shtuar e markimit CE është që të gjitha vendet e BE-së duhet ta lejojnë shitjen e produkteve të ndërtimit që mbajnë markën CE. Kjo do të thotë se autoritetet publike nuk mund të kërkojnë ndonjë markë ose certifikatë shtesë e, po ashtu, jo më shumë testim shtesë. Prandaj kompanitë prodhuese ose distributorët e produkteve janë në gjendje ta tregojnë produktin në çdo vend evropian me të njëjtin dokumentacion. Së



bashku me deklaratën e performancës, kjo do t'i ndihmojë klientët dhe përdoruesit përfundimtarë të kontrollojnë performancën e produktit dhe ta krahasojnë me produkte të tjera në të njëjtën qasje teknike. Kur prodhuesi vendos markën CE në një produkt, kjo do të thotë se kompania është duke siguruar që performanca e produktit që po shitet është e njëjtë me atë që deklarohet. Pra, duke përdorur specifikimet teknike

të duhura evropiane", është theksuar në komunikatën e OEK-ut.

Po në komunikatë është theksuar se transpozimi i CPR-së 305/2011 është në fazën finale (aktualisht në lexim të dytë) dhe si e tillë gati ka kaluar të gjitha procedurat për miratim final nga Kuvendi i Kosovës. "Megjithëse Kosova nuk ka trupa notifikuarë meqenëse nuk është anëtare e BE-së, si lehtësim për produktet e ndër-

timit kosovar, parashikohet të kemi trupa të emëruar për vlerësim të konformimit, të cilët do të emërohen nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Aktualisht ekzistojnë 11 laboratorë testues për materialet e ndërtimit të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës", thuhet në komunikatën e OEK-ut.

Markimi CE përmban disa informacione thelbësore rreth produktit dhe siguron një lidhje me dokumentet e tjera shtesë të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme. Pajisja me CE markë jo vetëm që konsiston në vendosjen e etiketës tek produkti, nga ana tjetër prodhuesit duhet të kryejnë shumë detyra për ta përfunduar procesin e shënimit të markës CE. "Prodhuesi ose përfaqësuesi i kompanisë është përgjegjës për vendosjen e markës CE. Vendosja e simbolit të markës CE duhet të jetë në përputhje me direktivën 93/68/EC dhe të

tregohet mbi produktet, pakehimin ose dokumentin komercial shoqëruar", është theksuar në komunikatën e OEK-ut.

OEK-u ka njoftuar se përfitimet e kompanive janë të mëdha pas shënimit të markës CE, duke ndikuar kështu në depërtim më të lehtë në tregjet e BE-së dhe përafrim me vlerat evropiane në fushën e sigurisë së produktit.

Oda Ekonomike e Kosovës ka apeluar tek bizneset vendore që ta kuptojnë rëndësinë e ndërkombëtarizimit të ndërmarrjes vendore, në veçanti përmbushjen e normave dhe kriterëve të kërkuara për prodhimet "Made in Kosova" me qëllim të shfrytëzimit të mundësive që ofron MSA-ja si dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare. "Përmirësimi i bilancit të pagesave është i një rëndësie strategjike për Kosovën, prandaj markimi dhe brendimi janë në funksion të arritjes së këtyre objektivave", është thënë në komunikatën e OEK-ut.

Hamza: Legjislacionin tatimor do ta kemi në përputhje me direktivat e BE-së



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Funkcionalizimi i ekonomisë së tregut si dhe reformat në politikat fiskale të vendit janë të domosdoshme për lehtësimin e mëtejshëm të të bërit biznes, por edhe për fuqizimin e sektorit privat në Kosovë. Kjo u tha gjatë një takimi të ministrit të Financave, Bedri Hamza, me drejtuesit e kompanive anëtare të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka shprehur gatishmërinë e Odës Amerikane për të kontribuar me rekomandime për procesin e plotësim-ndryshimit të legjislacionit tatimor. Ai ka shprehur shqetësimet e Odës Amerikane sa i përket menaxhimit të parasë publike, veçanërisht disa

vendimeve të cilat mund të çojnë në rritjen e ngarkesës fiskale për bizneset.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka sqaruar se rrezikimi i stabilitetit makrofiskal në Kosovë mund të krijojë probleme si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Ai ka theksuar se synim i Ministrisë së Financave vazhdon të mbetet përkrahja e sektorit privat për lehtësimin e eksportimit të produkteve në tregun rajonal, duke pohuar se ky ka qenë qëllimi i masave fiskale të zbatuara nga ana e Ministrisë së Financave për lirime doganore dhe shkurtim të procedurave doganore. Hamza ka njoftuar se MF-ja është duke punuar për ndryshimin e legjislacionit tatimor në përputhje me direktivat e BE-së.

Papunësia në tremujorin e parë, 26.5 për qind

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë (TM1) 2018, i cili përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, statusit të punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe çështjeve të tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me tregun e punës.

Anketa ka pasur shtrirje në 598 qarqe regjistruese në tërë territorin e vendit, ku janë anketuar 3 531 ekonomi familjare. Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë në moshë pune. Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 39.2 %, kurse shkalla e punësimit në anketën e fuqisë punëtore (AFP) për tremujorin e

parë 2018 është 28.8 %. Punësimi më i lartë është te meshkujt 45.5%, ndërsa punësimi te femrat është 11.8 %. Sipas rezultateve të AFP-së, në tremujorin e parë 2018 shkalla e papunësisë është 26.5 %. Papunësia më e theksuar është te femrat me 28.7 %, krahasuar me meshkujt 25.9 %. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 54 %.



Kërkohet që 'Trepçës' t'i hapet rruga e zhvillimit ekonomik

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt, në të cilën është shqyrtuar projektstatuti i ndërmarrjes "Trepça". Kryetari i Bordit të "Trepçës", Ardian Sylja, ka thënë se prej që është miratuar Ligji është ndërmarrë vetëm një hap, ai i formimit të bordit. "Prej atëherë si bord kemi pasur takime intensive dhe detyrë primare ka qenë hartimi i draft-statutit", ka thënë Sylja.

Ai ka apeluar që ky draft-statut të kalojë sa më shpejt në mënyrë që "Trepçës" t'i hapet rruga e zhvillimit. "Ky statut duhet të kalojë sa më shpejt në mënyrë që t'i hapet rrugë regjistrimit të shoqërive aksionare siç është paraparë me ligj", ka thënë Sylja.

Kurse kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, Shyqyri

Sadiku, ka thënë se draft-statuti nuk është punuar nga bordi por, sipas tij, ka shkuar dokument i gatshëm nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Ai ka thënë se kjo paraqet shkelje ligjore. "Ne jemi aksionarë dhe askush nuk na ka marrë parasysh si sindikatë. Ky është shqetësimi ynë më i madh. Ligji për 'Trepçën' thotë se e obligon bordin ta bëjë statutin dhe jo dikush tjetër", ka thënë ai.

Ibrahim Rexhepi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka sqaruar draft-statutin e ndërmarrjes "Trepça". Ai ka bërë me dije se një gjë e tillë është bërë për ta respektuar afatin kohor. "Ka vonesa që nga viti 2016 dhe për shkak të këtyre vonesave qasja e ministrisë ka qenë që të formohet një statut", ka thënë Rexhepi. Ndërsa Naser Peci, anëtar i bordit mbikëqyrës të ndërmarrjes "Trepça", ka thënë se ky draft-statut nuk është përfundimtar. "Dikush është duke e konsideruar si dokument përfundimtar,



por për mua është dokument themeltar. 'Trepça' është ndërmarrje nacionale dhe të gjitha çështjet i zgjidhim së bashku", ka thënë ai.

Pas gati dy orësh diskutimi,

deputetja Duda Balje ka propozuar që për këtë çështje të formohet një grup punues dhe të harmonizohen të gjitha çështjet. Propozimi i saj u pranua nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe

u vendos të formohet një grup punues. Deputetja Mimoza Kusari-Lila ka propozuar që përmes një neni të veçantë të hyjnë të gjitha pasuritë që ka "Trepça".

Lluka paralajmëron aktivizimin e Bursës së Energjisë në fillim të vitit 2019



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - "Bursa e përbashkët e energjisë shërben për të vendosur një çmim referent në tregun vendor i cili mundëson likuiditet më të madh dhe zhvillim të konkurrencës në treg, ndërsa bashkimi me tregun e energjisë Kosovë - Shqipëri ndikon në mirëqenien ekonomike të të dyja vendeve dhe do të sjellë përfitime për to", ka deklaruar ministri i

Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Këto komente kreu i MZHe-së i ka bërë të hënën gjatë Forumit të Dytë Ndërkombëtar 'Bashkimi i tregut në sektorin e energjisë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës - roli i krijimit të shkëmbimit të përbashkët të energjisë në këtë proces", që u mbajt në Prishtinë.

Duke folur për këtë proces Lluka

tha se të dyja palët janë duke punuar për implementimin e udhërrëfyesit për integrimin energjetik evropian. "Janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit, një në vitin 2014 për integrimin e tregut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe një marrëveshje tjetër është nënshkruar në vitin 2017 për krijimin e bursës energjetike", tha ai. Sipas tij, në këtë bursë energjetike

do të jenë aksionarë OShE-ja dhe KOSTT-i, por u lihet hapësirë edhe operatorëve të tjerë që duan të jenë pjesë e saj. "Për këtë është formuar një grup i përbashkët i cili është duke punuar për aktivizimin e këtij projekti të rëndësishëm për vendin", ka thënë ministri Lluka. Ai ka rithek-suar se problem është Serbia, e cila nuk po e respekton marrëveshjen për energjinë. Sipas tij,

Serbia është duke pamundësuar integrimin e tregut të përbashkët me Shqipërinë. "Po ashtu është duke pamundësuar edhe përfshirjen e KOSTT-it në bursën shqiptare", ka thënë Lluka. Ai ka paralajmëruar se deri në fund të këtij viti pritet që Kosova të jetë një bllok i pavarur energjetik. "Rrjedhimisht bursa të jetë aktive nga fillimi i vitit 2019", është shprehur ministri Lluka.

Sofrat tona janë mbushur me pr

Kjo xhurulldi e krijuar nga ministri i MBPZHR-së, Rikallo, nuk është asgjë e re dhe as e papritur. Aty ku ka para dihet se emërohen ose zgjidhen zyrtarë nga të fuqishmit e vendit që ta kontrollojnë dhe ta kanalizojnë ku e te kush duhet të shkojnë ato para. Edhe ky rast është pasojë e konfrontimit të interesave të të fuqishmëve që janë në piramidën e shtetit tonë të kapur



Nga Shemsi SYLA

Të rikthehem pak pas në histori: Ultranasjonalistët serbë, duke filluar nga Garashanini, Klubi Kulturor serb, Konventa famëkeqe për shpërnguljen e shqiptarëve e vitit 1938, me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, vazhduan përpjekjet për realizimin e planeve si, p. sh.:

- This is a premium name
- This is a premium name
- Elaborati i ri i Vasa Çubrilloviqit, i titulluar "Problemi i pakicave në Jugosllavi". Ai pushtetin e ri e "mëson" se, përveç spastrimit nga ana e ushtrisë gjatë operacioneve, duhet zbatuar edhe metoda të tjera në mënyrë që pakicat kombëtare të detyrohen të shpërngulen, të krijohen për ta kampe përqendrimi, ndërsa pasuria e tyre të konfiskohet. Kurse në një letër dërguar Titos e këshillon të nxirret një ligj që t'u merren dhritë shqiptarëve pasi me këtë arrin di qëltime: shkatërrimin e ekonomisë dhe shëndetit të shqiptarëve. Dhe kjo këshillë dihet se u zbatua. Organet shtetërore të të dy Jugosllavive, veçmas asaj të Kralit, dëshironin që nën maskën e reformës agrare dhe të kolonizimit ta realizonin politikën për shtypjen brutale të popullsisë shqiptare, konfiskimit të tokës së fshatarëve shqiptarë, ta nxiste tendencën e shpërnguljes së saj në Turqi e në Shqipëri dhe ta realizonin idenë e nacionalizimit dhe të ser-

bizimit të Kosovës. Me këtë, politika hegjemoniste jugosllave, duke e konsideruar se popullata shqiptare homogjene autoktone, e cila jeton në numër të madh dhe vështirë mund të asimilohet për shkak të kulturës dhe gjuhës tjetër nga ajo sllave, gjeti metodën e terrorit, të dhunës, të marrjes së tokës dhe të shpërnguljes me dhunë të popullatës shqiptare jashtë atdheut të tyre, dhe me këtë të fitojë sipërfaqe të mëdha toke të punueshme, ku do të vendoseshin një numër të madh të kolonëve.

Me qëllim të rrëmbimit të tokave, ushtria dhe xhandarmëria shpeshherë së bashku edhe me elementin kolon, të cilin e furnizonin me armë dhe municion, hidheshin në aksion terrori kundër shqiptarëve. Kolonët të ashtuquajtur vullnetarë, çetnikë, optantë etj., kishin ardhur gati nga të gjitha viset e Jugosllavisë borgjeze, si nga Mali i Zi, Hercegovina, Bosnja, Dalmacia, Lika, Korduni, Bania, Serbia Jugore, Vojvodina etj. Mirëpo, kishte kolonë të ardhur edhe nga disa shtete të jashtme si nga Rusia, Italia, Hungaria, Shqipëria, Amerika etj. Atyre pushteti u jepte prona të mëdha të tokës, sipërfaqja më e madhe e marrë nga pronarët shqiptarë, duke i detyruar ata të shpërngulen ose të bëhen shërbëtorë "të agallarëve" të rinj, duke ua punuar tokën dhe duke e paguar edhe tatimin për atë tokë. Pushteti, kolonët i vendoste edhe në shtëpitë e fshatarëve vendës shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës se dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte edhe shtëpitë, si dhe u jepte ndihmë në material ndërtime, vegla pune, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore për 10 vjet dhe nga ato komunale për pesë vjet, kurse të

drejtën e plotë si pronarë - me të drejtë për të shitur atë do ta merrni pas dhjetë vjetësh, transportin falas të tyre, të materialit ndërtime, veglave të punës, bagëtive etj. deri te vendi i vendosjes etj.

U formuan kooperativat agrare nga të cilat kolonët merrnin kredi pa kamatë, material ndërtime dhe ndihma të tjera. Në mesin e kolonëve të ardhur, që shteti u kishte dhënë tokë, përveç fshatarëve bujq, kishte edhe tregtarë, pensionistë, oficerë, xhandarë, nëpunës etj. Për t'i nxitur dhe për t'i tërhequr kolonët që të vijnë dhe të vendosen në Kosovë, makineria propaganduese serbe përdorte në forma të ndryshme propagandën se në Kosovë ka tokë me bollëk, shtëpi të lira etj.

Kolonëve të ardhur sllavë, pushteti, përveç tokës "utrinë", kullota e të tjera, u ndante posaçërisht tokë të punueshme pjellore të marrë nga pronarët shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të shpërngulen jashtë vendit ose ta marrin nga kolonët e të punojnë tokën e vet përgjysmë ose me qesim dhe për të edhe të paguajnë më tutje tatimin. Tokën pronarëve shqiptarë pushteti ua merrte edhe me motivacion se është përfshirë në kompleksin agrar dhe për atë shpesh nuk jepte kurfarë kompensimi, ose nëse jepte atë tokë e jepte të cilësisë së dobët. Siç është theksuar më parë, për zbatimin e kolonizimit ishin të angazhuara të gjitha organet e pushtetit, duke filluar nga ato më të ulëtat lokale e deri tek ato më të lartat shtetërore. Pra, ishte angazhuar tërë makineria shtetërore.

Ndërsa si rrjedhojë e spastrimeve etnike dhe e kolonizimit të tokave shqiptare u bë ndryshim i ndjeshëm i strukturës etnike të popullsisë. Bazuar në shënimet statistikore, qeveria arriti që në Kosovë, në periudhën midis dy luftërave, siç thuhej për nevoja të reformës agrare, t'i kufizojë rreth 129 212,94 ha tokë. Ndërsa gjatë kësaj periudhe janë vendosur 13 482 familje me rreth 67 410 anëtarë në 594 vendbanime. Sipas një burimi tjetër, në 14 rrethe të Kosovës 21 876 familjeve u është dhënë 81 134,49 ha. Sipas një raporti të Drejtoratit Suprem të

Reformës agrare në Shkup, deri në fund të muajit tetor 1940, për drejtorinë agrare në Pejë, Ferizaj, Shkup dhe Prizren janë kufizuar 381.245 ha tokë. Tokë në masë të konsideruar u është dhënë kishave dhe manastireve ortodokse, stacioneve të xhandarmërisë etj.

Sipas një raporti të Drejtorisë Supreme të Reformës Agrare në Shkup, sek. nr. 344, datë 12. XI. 1940, në territorin e kësaj drejtorie kishave dhe manastireve u janë ndarë 569 ha tokë, ushtrisë 1 342 ha, xhandarmërisë 250 ha dhe të tjera. Në anën tjetër merrej edhe prona e vakëfeve, xhamive, teqeve etj. pa kurfarë kompensimi dhe në forma të ndryshme perfide. Nuk është mbajtur ndonjë evidencë e mirëfilltë për marrjen e këtyre pronave duke i konsideruar si prona të lira ose të përfshira në kompleksin agrar. Duhet përmendur se pushteti agrar në vitin 1927, Manastirit të Deçanit i dha prona të 50 familjeve shqiptare të fshatit Isniq, ndërsa Manastirit të Deviçit iu dhanë prona të 20 familjeve shqiptare të fshatit Llaushë, komuna e Skenderajt.

Por, përkundrejt këtyre masave shqiptarët nuk hoqën dorë nga prona dhe nga toka e tyre dhe rrjedhimisht nga identiteti i tyre, duke e blerë e riblerë edhe nga dy e tri herë tokën e tyre. Dhe tokën e punuar deri në fund të luftës dhe duhet të përkujtojmë që edhe në luftën e fundit ushtria shkatërroi e dogji ara të mbjella me drithëra krahas vrasjes së njerëzve vrau edhe bagëti dhe shkatërroi duke i vjedhur e plaçkitur si bagëtinë ose mekanizmin bujqësor. Kjo bëhej me qëllim që të shkatërrohet baza e jetesës së shqiptarëve. Sipas të dhënave statistikore, Kosova deri në fund të luftës më 1999 kishte rreth 550 mijë hektarë tokë pune, mbi 200 mijë hektarë pronë shoqërore apo e kooperativave.

Cila është gjendja e bujqësisë dhe e fshatit sot në Kosovë?

Përgjigjja më e shkurtër është se atë që nuk arritën ta bënin Serbia dhe Jugosllavia okupatore për 90 vjet, e bëmë ne vetë

për pak vjet. Në radhë të parë Serbia, siç e theksuam më sipër, jorastësisht dogji dhe shkatërroi fshatrat shqiptare, bagëtinë dhe mekanizmin bujqësor. Si rezultat i kësaj, pas luftës pati një koncentrim të madh të popullatës rurale në qytete, duke u ndryshuar

struktura demografike dhe duke u krijuar probleme të rënda sociale dhe sot si rezultat të kësaj kemi rajone të tëra të boshatisura kryesisht të viseve kodrinore-malore siç është braktisja e Gollakut, Rugovës, Karadakut, Shalës së Bajgores, po edhe të fshatrave në rajonet e Kosovës qendrore si Drenicë, Llapushë etj., në anën tjetër shkallë kaq të lartë të papunësisë e të rasteve sociale në qytete. Tokat bujqësore në Kosovë që nga pas lufta janë shkatërruar në masë të madhe. Këto toka janë shndërruar në zona industriale, në banesa kolektive, objekte afariste e komerciale, ndërkohë që parandalimi për shkatërrimin e tyre ka munguar përgjatë viteve e që, sipas disa shifrave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbi 500 hektarë shkatërrohen vetëm brenda një viti. Po ashtu, ka uzurpime të mëdha.

Problem mjaft i madh që i shkaktoi bujqësisë dhe zhvillimit rural, dihet se ishte privatizimi, pa u respektuar asnjë kriter dhe tokat bujqësore të sektorit shoqëror u bënë prona të agallarëve të rinj shqiptarë, që thuhet se një ari tokë e blen për 1 euro dhe e keqja nuk është këtu, por atyre tokave ose iu ndryshua destinacioni, siç u tha më sipër, ose ngelën djerrina sot e kësaj dite. Shembuj konkretë mund të shihen kudo në Kosovë e me këtë rast po i përmend dy a tri sosh: Fushat e pemishtës së "Malishgait" të Klinës që shihen nga rruga e kombit, pastaj vreshtat e rrushit të Suharekës, apo toka e kooperativës bujqësore të Becit të Gjakovës, që sot janë shndërruar në shkurre e barishte. Toka punohet fare pak edhe nga bujqit tradicionalë, sidomos kultivohen fare pak drithërat, kryesisht gruri dhe misri që në të gjitha shtetet e botës konsiderohen prodhime strategjike.

Kjo ndodh për shkak se bujku, çfarëdo që kultivon, prodhon

Fillon regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta në Malishevë

Malishevë, 18 qershor (ER) - Në Komunën e Malishevës ka filluar të hënën regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta për vitin shkollor 2018/2019, i cili do të zgjasë tri ditë. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka pohuar se drejtoria është e përgatitur për këtë proces të regjistrimit. Po ashtu, ai ka bërë me dije se janë bërë përgatitjet edhe për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018. Në këtë mbledhje drejtorët e drej-

torive kanë raportuar edhe për aktivitetet e tyre për javën e kaluar dhe për javën në vijim. Gjithashtu, është raportuar edhe për vazhdimin e realizimit të projekteve nga lista e projekteve kapitale si dhe për projektet të cilat pritet të fillojnë në ditët në vazhdim.



Produkte të dyshimta

humbje për shkak të tregut liberal, mosmbrojtjes së prodhimeve vendore nga shteti, pas-taj mossubvencionimit adekuat, mosregresimit të naftës, të makinerisë bujqësore etj. Kosova që nga viti 2005 ka në fuqi Ligjin për tokën bujqësore i cili ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe rregullimin e tokës bujqësore. Por, ky ligj nuk zbatohet.

Nga degradimi i tokës bujqësore ekspertë të bujqësisë, kishin konstatuar se Kosova deri në fund të dekadës së parë të këtij shekulli do të ketë krizë në sigurimin e ushqimit. Sipas tyre, sipërfaqja e tokës së punuar në Kosovë është mjaft e ulët, që llogaritet të jetë 0.15 hektar për kokë banori. Ndërkaq, sipas standardeve ndërkombëtare, minimumi ekzistencial për prodhimin e ushqimit të mjaftueshëm, është 0.17 hektar për kokë banori. Fatqësisht ky parashikim i ekspertëve doli i saktë. Sot Kosova eksporton qindra miliona euro për ushqim të degraduar kryesisht në Serbi. Është thënë edhe më herët se gruri dhe mielli që eksportohet nga Serbia është i cilësisë së dobët, madje vjen nga rezervat shtetërore të Serbisë dhe këtu shitet pasi veterinarët e Serbisë e ndalojnë atë grurë që të bëhet ushqim për kafshë. Ata që kalojnë nëpër Serbi tregojnë se në pjesën jugore të këtij vendi nga Nishi e Kryshevci e vetmja prodhimtari aktive që shihet janë fabrikat e vogla të ushqimit të kafshëve, të cilin ushqim mund ta shesin vetëm në Kosovë.

Po kaq keq është edhe blegto-ria. Fondi i bagëtisë së imtë, veçmas i deleve dihet se ka pësuar dëmtim e zvogëlim drastik. P. sh., nga një statistikë e zyrave të vendit të rajonit të Gollakut nga viti 1970 deri në vitin 1982, brenda viti janë eksportuar në Greqi rreth 70 mijë qengja, që përkthyer në para me çmimin e sotëm i bie gati 10 milion euro. Sot në gjithë këtë regjion nuk mund të gjen-den mbase as 100 krerë dele. Edhe më keq është gjendja me dhi. Këtu duhet përmendur një rast interesant që nuk u bë kurrë temë e publikut. Pas luftës pat filluar ngritja e miniferlave të dhive dhe Agjencia e Veterinës

arriti të krijonte edhe kartela për secilën fermë dhe ishte shpresë e madhe se fermat e dhive do të ishin një krah i fortë i zhvillimit të këtij vendi. Por, kur gjithçka kishte marr të mbaren, në Maqedoni u sëmuren dhite nga bruceloza dhe Kuvendi i Maqedonisë merr vendim për asgjësimin e tyre dhe kompensimin e fermerëve. Po çka ndodhi? Ato dhi nuk u asgjësuan, por tregtarët shqiptarë, (ndoshta edhe maqedonas) i sollën në Kosovë dhe i shitën më çmime të ulëta. Pati plot raste të sëmurdjeve të njerëzve dhe kjo mjaftoj që fermat e dhive të treteshin si fluska sapuni në uji.

Diçka më e mirë është gjendja me kultivimin e lopës. Mirëpo, sado që kishte plot raste serioze të fermerëve të vendit, por edhe të njerëzve të ardhur nga diaspora që të ngritin ferma të lopëve qumështore, apo për majmëri as kjo nuk pati sukses për shkak të çmimit. Pra në emër të liberalizimit të tregut shteti u ka dhënë monopol të plotë tregtarëve në dëm të prodhuesit vendor. Dhe si rezultat i kësaj sot në sofrat tona në vend që të ushqeheshim me drithëra, mish, prodhime qumështi, pemë e perime cilësore të vendit tonë dhe praja të qarkullonte brenda vendit dhe tu ndahej njerëzve tanë dhe kështu të ulej edhe shkalla e papunësisë dhe emigracionit të paligjshëm, ne sot ushqehemi me ushqime me prejardhje të dyshimtë, jo rrallë edhe të kontaminuar dhe afër një miliard euro eksportohen për ushqim jashtë vendit, diku mbi gjysmë miliardi në Serbi. Një problem që ka ndikuar në shkatërrimin e bujqësisë dhe degëve të saj janë edhe kreditë bankare, të cilat në fakt janë fajde dhe kamata aq e madhe për bujqësi arsyetohet me shkallën e lartë të rrezikshmërisë.

Por shkaktari kryesor i sjelljes së bujqësisë kosovare në këtë gjendje është vetë koncepti shtetëror për bujqësinë, sepse dihet që nga themelimi i institucioneve qeveritare në vend, bujqësia u trajtua si segment i dorës së dytë në mos i së tretës dhe përderisa nuk janë rritur fondet e granteve kjo ministri u

është lënë ta udhëheqin partitë minoritare. Subvencionet janë të vogla dhe nuk kanë ndonjë peshë, kurse është fshehtësi publike se secili përfitues i një granti, apo subvencioni më të madh, duhet të jap ryshfet diku rreth 30 për qind të shumës së grantit, plus 18 për qind TVSH. Krahas kësaj projekti që miratohet ai paraprakisht duhet të jetë hartuar dhe më pas të realizohet në të gjitha fazat në "zyrtarë" e "ekspertë" të caktuar, qofshin të institucioneve qeveritare, apo edhe të agjencive të ndryshme. Pra, mjetet e granteve dhe subvencioneve që quhen për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit kanë shkuar gjithmonë në xhepat e tregtarëve, klienteles së pushtetit dhe ajka në xhepin e pushtetarëve. I vetmi rast pozitiv për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë sot është trekëndëshi Rahovec-Xerxë-Krushë e vogël-Mamushë. Prodhimet cilësore të domateve të këtij vendi shitën pa asnjë pengesë në tregun e BE aq sa ata mund të prodhojnë. Dhe e keqja më e madhe e shkatërrimit të bujqësisë dhe të mjedisit rural është humbja e shprehur së punës së njerëzve të këtij nënqielli. Dihet shumë raste në histori që pushtuesi u ka dhënë ndihma falas banorëve të një vendi të pushtuar. Natyrisht jo nga dashuria për ta. Por dihet se humbja e shprehur së punës dhe dembellëku shënojnë fazën e fundit të shkatërrimit të një shoqërie dhe të një kombi.

Çka duhet bërë?

Nëse synojmë ndërtimin e vendit, nëse dëshirojmë shëndet për popullatën, punësim të shpejtë, ushqim cilësor, moseksportim të parasë, kthimin e shprehur së punës dhe ndalimin e emigracionit masiv, Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e vendit duhet që bujqësinë ta shpallin prioritet qeveritar dhe të evitohen të gjitha këto dëme e të meta që i janë shkaktuar bujqësisë në Kosovë dhe rrjedhimisht shoqërisë dhe banorëve të saj.

(Autori është deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje)

Jashari: Skenderaj dhe gjithë Drenica mbeten çerdhe e lirisë

SKENDERAJ, 18 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka shënuar të hënën 19-vjetorin e çlirimit. Autoritetet lokale dhe qendrore kanë bërë homazhe tek Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Pas homazheve, Kuvendi Komunal i Skenderajt ka mbajtur një seancë solemne. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se kjo komunë dhe Drenica në përgjithësi vazhdojnë të mbeten çerdhe e lirisë. "Ashtu siç ishin dje çerdhe dhe vatër lirie, sot janë vatër e çerdhe përkushtimi, devotshmërie dhe angazhimi për secilin qytetar dhe pjesë të Komunës së Skenderajt", ka thënë Jashari, duke shtuar se janë zotuar se do ta vazhdojnë rrugën e dinjitetit që e shtruan të parët e këtij vendi. "Sot në këtë mbledhje solemne, me nderim dhe guxim e ndersh-

mëri vijojmë rrugën e dinjitetit që na e shtruan të parët tanë, duke rikonfirmuar se Skenderaj dhe gjithë Drenica ishin dhe mbeten çerdhja e lirisë, çerdhja e trimërisë, e punës dhe begatisë. Në këtë ditë çlirimi të Skenderajt zotohemi dhe angazhohemi të punojmë për mirëqenien e secilës familje, në veçanti për të rinjtë tanë", ka thënë Jashari.

Ai për këtë ditë nuk la pa përmendur edhe kontributin dhe sakrificën e të gjithë luftëtarëve të lirisë dhe familjes së tij. "Në këtë përballje ne humbëm edhe më të dashurit që më nuk janë në mesin tonë, por tash i kemi në libra historie, me kryefjalën e lirisë sonë, babës Shaban, bacës Adem, babës Hamëz e shumë e shumë heronjve e dëshmorë të vendit tonë", ka thënë Jashari.



Ndahen mirënjohje për studentët fitues në garën për gjykim të simuluar

Mitrovicë, 18 qershor (ER) - Rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Alush Musaj, dhe dekan i Fakultetit Juridik, Agron Beka, kanë ndarë mirënjohje për grupin e studentëve që kanë zënë vendin e parë në garën për gjykim të simuluar. Gjithashtu janë nderuar

me mirënjohje edhe dekan Beka dhe koordinatori i grupit të studentëve, profesor Zahir Çerkini, për këtë arritje në garën e organizuar nga "National Center for State Courts" (NCSC), në të cilën kanë marrë pjesë studentët nga pesë universitetet publike në Kosovë.

Rektori Musaj ka uruar stafin akademik dhe studentët e Fakultetit Juridik për këtë sukses. "Suksesi juaj na bën krenarë të gjithëve. Ju keni dëshmuar se, pavarësisht prej kushteve jo të mira, me punë mund të bëhet shumë", ka thënë Musaj.



AFRIM KQIKU, QYTETAR NDERI I GJILANIT



Ismet SYLEJMANI

Popujt e mëdhenj nga gjiri i tyre gjithmonë kanë nxjerrë personalitete të mëdha e të lavdishme, të cilët me kontributin e tyre të gjithanshëm e të vazhdueshëm në shërbim të atdheut e kombit të tyre, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme, për çka populli e gjeneratat që do të vijnë, përgjithmonë do t'u jenë mirënjohës.

Populli e kombi ynë shqiptar në mesin e vet e ka njërin prej bijve të saj të famshëm, fotografimin legjendar jo vetëm të Gjilanit e të Anamoravës, por të Kosovës dhe të gjithë shqiptarisë, të madhin dhe të papërsëritshmin, pronarin moral e shpirtëror, material e njerëzor të studios prestigjioze "FOTO FARI", të nderuarin Afrim Kqiku.

Afrim Kqiku është personalitet të cilin, në momentin që e zë në gojë dhe fillon të flasësh e të mendosh për të, të del para syve një histori e tërë heroike dhe lavdimadhe e një populli, që për shekuj e dekada ka luftuar për liri e çlirim, pavarësi e prosperim kombëtar e politik, tokësor e ekonomik.

Afrim Kqiku është vetë jeta e qytetarit shqiptar gjilanas, anamoravas, karadakas e kosovar.

Afrim Kqiku është emblema e



fotografisë shqiptare jo vetëm në Gjilan.

Nëpër duart e tij dhe të objektivit të aparatit të tij fotografik është pasqyruar tërë realiteti i hidhur pushtues i Serbisë mbi shqiptarët jo vetëm në Gjilan, por edhe më gjerë.

Kur të përmendet ky personalitet e kjo figurë e madhe të dalin para syve, si një shirit gjigand, ngjarje të vazhdueshme të së kaluarës së faktuar me foto e foto...

Afrim Kqiku është kryepersonazhi qendror, i pakapërcyeshëm

dhe i paarritshëm për plasimin e fotografisë si argument dhe realitet, përmes të cilit dëshmohet katërcipërisht, se një foto është më shumë sesa 1 000 fjalë. Afrim Kqiku është dhe mbetet pika e vetme referuese përmes të cilit deshifrohet çdo event madhor dhe e kaluar e pashlyeshme në Gjilan dhe më gjerë.

Nuk ka e nuk do të ketë qytetar gjilanas dhe me gjerë që, kur të përmendet fotografia, të mos i shkojë me shpejtësi mendja tek e famshmja "Foto Fari" dhe te


Afrim Kqiku.

Shpallja e Afrim Kqikut qytetar nderi i Gjilanit është mirënjohje e madhe jo vetëm për Afrimin, por për studion "Foto Fari", për familjen e tij dhe për të gjithë shokët dhe miqtë e tij.

E gëzofsh mirënjohjen dhe nderin që të është bërë, i nderuari shoku dhe miku im Afrim Kqiku!

Afrim Kqiku, Gjilani e ka për nder që të ka qytetar nderi.

Prishtine, 15. 6. 2018





Emine MALIQI-ZAIRI

VEÇ PËR AT' ZA

Folëm se ti fshij
 larat e bardha t'mes udhës
 t'nxjerr prej tana daljeve
 t'vjedh para tana ardhjeve
 natën me ditë ta përziej
 kokrrat e synit ti mjell fushes t'hutinit
 zojtë ti kthej n'mjedis dimnit
 Ti nuk e di
 andrrat ti lo pa shpi
 folëm po mujte
 pa zanoret e inatit
 me ngjyrën e flutrave t'barkut
 folëm
 kush po ia lidhka kaq keq
 kthizen fatit
 po t'mar me t'mirë
 se ta mar zonin jesir
 e ruj poshtëkafazit
 t'derë t'gurmazit
 sa here du
 t'vogel ner dhom
 bash me at' za
 ia knoj veti ma t'mirat kongë

QË SOT...

Për ty do t'pushoj së shkruari
 që sot
 sepse kujtesës time nuk i gjej krehër
 dhe vet mendimi se librin tim
 ndoshta një tjetër do ta ulë në prehër
 është e frikshëme
 radha e njerëzve që kam ndalur
 kërkimi i syve tu
 në ballë të huaj
 shikimi im i mallur
 duke kërkuar të falur
 për ty do të pushoj së shkruari që sot
 duke shpresuar
 një ditë do të më thuash
 se vetëm nga pafuqia
 pushove të më duash

QIELL I GJANË

Gjithë ky qiell
 veç ai shpend
 kush e di se çka end
 th'u që arnon qiell'n e grisun
 bartë naj rreze të braktisun
 i bjen bjeshkës permjedis
 prej në lisi n'tjetrin lis
 nashta k'tyne u'a bartë mallet
 me u ba bashkë
 nuk i lan malet
 nashta tjetër gja nuk di
 veç me knu për perendi

PREJ SE IU RRALLUN
PËRQAFIMET

Baba ka hi n'uj
 o voglu
 s'don me i ra tamom
 moshës që ka
 shtratit i voglohet si jetimët
 u menu qysh jo
 per mangët e k'mishës qe i teprojnë
 prej se iu rrallun përqafimet
 baba n'gjys t'dites gëzohet
 kur hija i zvoglohet
 s'don me i ra tamom moshës që ka
 don me u dok sa na.

ME FLATRA GJETHESH

Vë bast se zemra ime
 do të dilte qëmoti prej kafazi
 sikur të kishte së paku
 një palë flatra gjethesh
 që t'u tregonte zogjve tjerë
 se di të këndo
 dhe se atë tik-takun rutinor
 di ta bëj secila orë.

HANË NË TË SOSUN

Besomni
 se zgjohem në orën kur prostitutat
 kthehen bujtinave
 dhe minatorët ikin zgafellave
 një gjë e di
 se për punën e tyre
 asnjëherë nuk mund të dëshmoj dielli
 në mos besofshi
 zgjohuni e shihni
 se në këtë orë
 duket mbi çdo shtëpi
 një hanë në të sosun
 dhe nga një oxhak
 si kryq i tymosun

Ç'LOJË ASHT KJO?

Oqja maje pullazi
 kukanë
 th'u që do me u mytë ner t'shenjtin kulmin tem
 si gru e lanë
 kur e nxjerrin prej shpisë
 permas i vjen zoni i fmisë
 ç'lojë moj asht kjo
 a s'di s'i knohet
 çka je hasmu
 n'i tjetër kangë me tjetër zo
 s'osht lehtë me t'ngu
 pa u mundu me ta nrxanë
 jehonën e zanit
 rob diku
 o rri e msohu t'jesh veç shpend
 o shko e kno naj tjetër vend
 me t'ngja nuk du
 as humnera jeme
 ty kërku.

Nënshkruhet Kalendari Kulturor Kosovë - Shqipëri

PRIZREN, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Kosovës, Kujtim Gashi dhe ministrja e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro-Furxhi, në ambientet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nënshkruan të hënën protokollin e bashkëpunimit për Kalendarin e Përbashkët Kulturor Vjetor, të pestin vit radhazi.

Përmes këtij akti dy vendet janë pajtuar për përfshirjen e aktiviteteve kulturore në një kalendar të përbashkët, i cili është i bazuar në "Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës" nënshkru-

ar në Prizren më datë 11 janar 2014.

Në kalendarin e sivjetmë të përbashkët kulturor do të realizohen aktivitete në fushën e trashëgimisë, që kanë të bëjnë me digjitalizimin e trashëgimisë dhe trajnime e edukim në fushën e restaurimit dhe konservimit; ekspozita në fushën e arkeologjisë dhe të muzeve, në fushën e teatrove do të mbahet Festivali Mbarëkombëtar i Teatrit dhe do të realizohen shfaqje teatrale si në Kosovë dhe në Shqipëri, në fushën e filmit do të jepen premierat e pesë filmave.

Në fushën e artit pamor do të realizohet një ekspozitë në Shqipëri. Këto aktivitete do t'i



bartin institucionet kombëtare përkatëse të kulturës. Nënshkrimin e këtij kalendari ministri Kujtim Gashi e ka cilësuar si ditë shumë të rëndësishme për të dy vendet. Ai ka pohuar se të gjitha institucionet e kulturës dhe trashëgimisë do të kenë aktivitete të përbashkëta

edhe në Kosovë edhe në Shqipëri. "Mendoj se ky është një moment që dy institucionet tona janë në krye të organizimeve, pa e prekur pjesën e pavarur të institucioneve të kulturës. Besoj se këtë vit është më i veçantë sepse jemi ndalur në aktivitetet specifike", u shpreh Gashi, duke shfaqur edhe vlerësim për punën e ministres Kumbaro në raport me lobimin për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.

Ndërsa ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro-Furxhi, ka thënë se kultura e dëshmon më së miri se nuk ka kufi tjetër në mes të Kosovës dhe Shqipërisë përveç atyre

administrativë. Ajo pati vlerësim për institucionet e kulturës dhe skenën e pavarur kulturore të Kosovës. "Ne kemi njohur të gjithë energjinë që ka skena e pavarur e Kosovës me të cilën duam ta kemi një bashkëpunim, por edhe për të mësuar më shumë sepse skena e pavarur në Tiranë nuk e ka të njëjtën pjekuri. Kufijtë janë administrativë, kultura është si lumenjtë. Lumenjtë kur kalojnë vijën e ujin nuk pyesin a ka kufi. Ne duhet të krijojmë të njëjtin mjedis për kulturën", ka vlerësuar Kumbaro.

Që të dy ministrat thanë se koncepti i kalendarit të përbashkët është i hapur dhe do të përfshihen të gjitha vendet ku ka shqiptarë.

E jashtëzakonshme

E gjen motoçikletën që i kishin vjedhur 31 vjet më parë

Pronari i një motoçiklete 'Ciao', ngjyrë qielli, nuk shpresonte më ta gjente pronën e vjedhur më 25 shtator të vitit 1987 në Pavia të Italisë. Por, 31 vjet më vonë vjen dhe telefonata e karabinierëve të cilët i thonë: "Kemi gjetur motoçikletën tuaj".



FOTO E DITES



Parku zbavitës në Bagdad gjatë festimeve Eid al-Fitr, që shënon fundin e muajit të shenjtë mysliman të agjërimit të Ramazanit. /AP/

E rrallë

"UFO-t erdhën për Kupën e Botës!"

Një objekt i çuditshëm është filmuar së fundmi mbi Nizhny Novgorod të Rusisë, aty ku Anglia do të luajë më 24 qershor ndeshjen e dytë në Botëror. Pas publikimit të një video nga një qytetare ruse, të shumta kanë qenë komentet, ku disa prej tyre shkruanin se bëhej fjalë për një



objekt jashtëtokësor. "UFO-t erdhën për Kupën e Botës", shkroi një person.

BARSOLETA E DITËS



I burgosuri e pyet gardianin:

- Më fal, sa është ora?

Gardiani:

- Pse, ke për të shkuar ndokund a?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI
Fokusohuni tek financat sot sepse

çdo gjë tjetër do të shkojë qetë gjatë ditës. Edhe pse jeni të shqetësuar për një problem, do t'i jepni zgjidhje.



DEMI
Një çështje e rëndësishme

biznesi sot do t'ju mbajë nën tension gjatë gjithë ditës. Nuk do t'i jepni dot zgjidhje të shpejtë.



BINJAKËT
Edhe pse sot jeni disi

ëndërrimtar/e përsëri nuk e keni humbur kontaktin me realitetin. Qëndroni me këmbë në tokë.



GAFORRJA
Çaste kreativiteti sot për ju dhe

qëndrim në ambiente artistike ku doni të mësoni gjëra të reja.



LUANI
Sot nuk jeni të kënaqur nga ana

sentimentale. Ndjenjat që provoni për dikë nuk kompensohen në mënyrë reciproke dhe kjo gjë ju mërzit.



VI R G J Ë R E S H A
Dita juaj sot nuk ka vetëm

ngjyrat e entuziazmit që ju shoqëron gjithmonë, por edhe ato të pasionit. Jeni shumë sharmante.



PESHORJA
Tensionet dhe keqkuptimet e të

shkuarës dalin në pah gjatë ditës së sotme. Debate të ashpra priten gjatë pjesës së dytë të ditës.



AKREPI
Sot ndiheni romantik dhe doni të

qëndroni vetëm pranë njeriut të zemrës. Kushtet e ditës nuk jua lejojnë këtë gjë për shkak të angazhimeve.



SHIGJETARI
Më në fund keni filluar të

lëvizni në fushën e financave, sepse po shikoni që të tjerët kanë marrë përfitimet e investimeve tuaja.



BRICJAPI
Miq të do t'ju lënë hapësira

veprimi gjatë ditës së sotme, sepse e dinë që ju keni qejf të bëheni protagonist në rrethin shoqëror.



UJORI
Mungesa e anës

financiare sot do t'ja vështirësojë punët, por ju nuk i shtrini këmbët asnjëherë më tepër se jorgani. Kështu që, do t'i menaxhoni ato që keni.



PESHQIT
Edhe pse sot është ditë

pune, ju ndiheni sikur e keni pushim. Nuk keni dëshirë fare t'u përkushtoheni impenjimeve tuaja.

Rikthehet Flori Mumajesi



Flori Mumajesi ka ndërmend të rikthehet sërish në Këngën Magjike për edicionin e 20. Që prej vitit 2015 kur sollti këngën "Me fjalë të vogla t'kam dasht", ai u shkëput nga festivalet për t'iu


përkushtuar më shumë koncerteve. Por burime për "Prive" kanë zbuluar se ai po punon për një projekt muzikor që do ta prezantojë këtë vit në "Këngën magjike".

Johnny Depp anulon të gjitha daljet publike me mediet



Johnny Depp ka anuluar të gjitha konferencat për shtyp dhe daljet publike për medie. Thashethemet mbi shëndetin e tij, pas daljeve në Rusi ku dukej shumë i zbehtë dhe i dobësuar,

kanë bërë që menaxherët e artistit të marrin vendime drastike për të mos rritur më shumë pëshpëritjet. Aktori nuk do të flasë për këtë temë", ka shkruar "The Times Magazine".




Bukuroshja kroate që mori vëmendjen e fotografëve në Kampionatin Botëror

Mediet kroate e kanë zbuluar identitetin e bukuroshes nga tribunat që e ka marrë vëmendjen e fotografëve në Kampionatin Botëror. Emri i saj është Ivana Knoll dhe dikur ka konkurruar për 'Miss'. Gjatë ndesh-

jes ndërmjet Kroacisë dhe Nigerisë në Kalinjingrad, në stadium ishte e pranishme edhe kroatja e bukur. Ajo është shndërruar në një sensacion në mediet kroate, por edhe në anën rozë të medieve në turneun më të madh ndërkombëtar.

Jolie viziton qytetin e rrënuar të Mosulit



Edërguara speciale e OKB-së për refugjatët, Angelina Jolie, të dielën ka vizituar kampin e refugjatëve sirianë në veri të Irakut, për t'i mbështetur të ikurit nga lufta disaveçare në Siri. Ylli hollivudian e ka vizituar kampin Domiz, në të cilin qën-

drojnë 33 000 refugjatë, të larguar nga lufta që po zgjat që shtatë vjet. Një ditë më parë Jolie e kishte vizituar Mosulin, qytetin verior të Irakut, të cilin forcat qeveritare e kanë kthyer nën kontroll në vitin e kaluar duke triumfuar ndaj militantëve të Shtetit Islamik.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

RUSSIA - EGYPT

GG

VARBERGS - HELSINGBORGS

2

POLAND - SENEGAL

1

Meta i dorëzon flamurin kombëtar ekipit shqiptar për Lojërat Mesdhetare 'Tarragona 2018'

"Epoka e re"

TIRANË, 18 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ia ka dorëzuar të hënën, në një ceremoni solemne, flamurin kombëtar ekipit dhe delegacionit zyrtar, që do të marrin pjesë dhe

do ta përfaqësojnë Shqipërinë në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" në Spanjë. Meta në fjalën përshëndetëse në këtë ceremoni, duke iu drejtuar sportistëve, ka thënë se në këto lojëra ekipi ynë olimpik i ka të gjitha shanset të ketë rezultate shumë të mira. "Është kënaqësi e veçantë t'ju

pres të gjithëve sot në prag të Lojërave Mesdhetare që do të zhvillohen në Spanjë. Me këtë rast ju uroj suksese në këto lojëra, për të cilat ju jeni përgatitur për një kohë të gjatë me një dëshirë dhe me një qëllim, për të përfaqësuar sa më mirë Shqipërinë dhe për të përfaqësuar në mënyrën më dinjitoze flamurin tonë kombëtar", ka thënë presidenti Meta, duke shtuar se Shqipëria në Lojërat Mesdhetare historikisht ka arritur rezultate shumë të mira në të gjitha sportet. "Besoj se edhe në këto lojëra ne i kemi të gjitha shanset falë përkushtimit, pasionit dhe talentit tuaj që përsëri të kemi rezultate shumë të mira. Jam shumë i gëzuar edhe për rezultatet e ekipit të volejbollit të femrave. Rezultatet e fundit tregojnë një rrizgim të asaj tradite të shkëlqyer që ne kemi pasur në këtë sport dhe në këtë për-



faqësim, pa dyshim edhe në shumë fusha të atletikës", ka thënë presidenti Meta. Duke i uruar suksese dhe përfaqësim sa më dinjitoz të ngjyrave kuq e zi, presidenti i Republikës ia ka dorëzuar flamurin kombëtar kampionit të Ballkanit dhe Evropës në kërcimin së gjati,

atletit Izmir Smajlaj. "Faleminderit shumë, z. President! Është nder dhe krenari për mua ta mbaj flamurin tonë kombëtar. Shpresoj që e gjithë skuadra olimpikë të sjellë rezultate sa më pozitive dhe sa më shumë medalje", ka deklaruar atleti Smajlaj.



KF Llapi zyrtarizon tre lojtarë

PODUJEVË, 18 QERSHOR (ER) - Fatbardh Latifi do të jetë lojtar i KF Llapit në katër sezonet e ardhshme. Qendërmbrojtësi shtatlartë që luajti në gjithë sezonin për "Ramiz Sadikun", është lojtari më i ri i Llapit. "Ai ka arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit dhe do të jetë pjesë e klubit për katër edicionet e ardhshme. Ne i dëshirojmë mirëseardhje Fatbardhit në familjen e madhe të KF Llapit dhe suksese në vazhdim", thuhet në njoftimin e KF Llapit të publikuar në faqen zyrtare në "Facebook".

Llapin e ka përforcuar edhe Shend Kelmendi. Sulmuesi është transferuar nga Trepça '89 dhe ka nënshkruar me Llapin për dy vjetët e ardhshëm. Llapi e ka zyrtarizuar edhe talentin Albion Osmani, i cili



ka nënshkruar kontratë trevjeçare me klubin e ri. Krahas prurjeve të reja në skuadër, KF Llapi ka vazhduar kontratat me futbollistët që bartën barrën kryesore të skuadrës në edicionin që lamë pas.

Kapiteni Hamdi Namani, mesfushori kryesor i skuadrës, Mentor Zhdrella, mbrojtësi i krahut, Benjamin Emini dhe sulmuesi Gentrin Begolli do të jenë pjesë e klubit deri në qershor të vitit 2019.

Salihu: Logoja e FFK-së është unike

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ditë më parë ka prezantuar fanellat e reja dhe logon e re. Logoja e re e FFK-së nuk është pritur mirë në opinionin sportiv në Kosovë, por kështu nuk mendon sekretari i FFK-së, Eroll Salihu. Në një prononcim për "Telegrafin", Salihu ka thënë se logoja është unike dhe atë e ka zgjedhur komisioni profesional. "Komisioni i ka prezantuar tri logot finale para Komitetit Ekzekutiv dhe së bashku ka zgjedhur logon që tani është. Kjo logo ka domethënie, pasi tek katrori i mesëm simbolizohet harta e Kosovës, ndërsa katrorët anash kanë domethënie për të



kaluarën tonë që kemi luajtur nëpër fusha dhe livadhe deri tek yjet e sotëm që kemi. Kjo simbolikë i ka pëlqyer shumë Komitetit Ekzekutiv dhe kryetarit të ndjerë, Vokrrit", ka thënë Salihu. Ai ka bërë me dije se logoja dhe fanellat janë dërguar në UEFA për Ligën e Kombeve. "Logoja nuk mund të ndryshohet së paku për dy vjet", është shprehur Salihu.

Nënshkruhet kontrata për përfundimin e ndërtimit të palestrës në Rahovec

RAHOVEC, 18 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar të hënën kontratën për fazën e fundit për ndërtimin e palestrës së sportit në qytetin e Rahovecit në vlerë 628 545 28 euro. Para nënshkrimit të kontratës, Latifi ka thënë se punimet për ndërtimin e palestrës në Rahovec kanë filluar në vitin 2008 dhe që nga atëherë

kanë kaluar 10 vjet dhe ende nuk është përfunduar. "Ndërtimi i Palestrës në Rahovec është projektuar dhe financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Gjatë ndërtimit të kësaj palestre janë ndërruar shumë ministra e Qeveri, mirëpo epilogun nuk ia dhanë asnjë ministër dhe asnjë qeveri. Presioni ndaj Qeverisë qendrore nga ana e



Komunës së Rahovecit gjatë mandatit tim të parë nuk ka munguar, por asnjëherë s'kam gjetur përkrahje nga ish-qeveritë.

Punimet në këtë palestër kanë shkuar me ritëm të ngadaltë dhe me neglizhencë. Kur unë mora besimin nga qytetarët e Rahovecit për këtë mandat, mandatin e dytë si kryetar komune, ndër premtimet e mia ka qenë që palestra të përfundohet sa më shpejt dhe Klubi i Basketbollit të Rahovecit, i cili luan në Super Ligë, t'i zhvillojë garat në këtë palestër", ka thënë

Latifi. Në këtë kontekst, ai ka thënë se gjithnjë ka logaritur në përkrahjen e kryeministrit Ramush Haradinaj dhe të ministrit të MKRS-së, Kujtim Gashi, me të cilin ka lidhur marrëveshje që procedurat e tenderimit për ndërtimin e palestrës për fazën e fundit t'i zhvillojë Komuna e Rahovecit, kurse financimin ta bëjë MKRS-ja.

Islandezët, dashuri pa kushte për futbollin, 99.6 % e tyre ndoqën ndeshjen

REYKJAVIK, 18 QERSHOR - Islanda ka një popullsi prej 334 000 banorësh dhe të gjithë kanë treguar se e dashurojnë futbollin. Në një publikim në rrjetin social në "Twitter" të Federatës së Futbollit të

Islandës, thuhet se rreth 99.6 % e islandezëve kanë ndjekur ndeshjen e kombëtares së tyre kundër Argjentinës. "Shpesh flitet për faktin se i gjithë populli qëndron pas djelmoshave tanë. Kjo mund të konfirmohet

sot: 99.6 % e të gjithë njerëzve që po shikonin televizion në Islandë gjatë ndeshjes Argjentinë - Islandë në Kupën e Botës në Rusi, po e shikonin ndeshjen", ka shkruar FFS-ja në "Twitter".



Mediet braziliiane sulmojnë ashpër Neymarin

BRAZILIA, 18 QERSHOR - Brazili nuk ka arritur të marrë më shumë se një barazim 1-1 kundër Zvicrës në Botërorin "Rusia 2018". Brazili kaloi në avantazh me golin e Cotinhos që në minutën e 20, por më pas nuk arriti të shënojë përsëri dhe u barazua në pjesën e dytë të ndeshjes. Por, pas përfundimit të ndeshjes, pre e sulmeve mediatike ka rënë Neymarin, i cili, edhe pse tentoi disa herë portën, nuk arriti të finalizojë me gol. Neymarin është cilësuar egoist dhe se ka harruar të luajë me ekipin dhe e mbante shumë topin.

Gazetari Osvaldo Paskual nga


"Fox Sport Brasil" ishte i ashpër ndaj Neymarit duke deklaruar: "Duke luajtur në atë mënyrë si ndaj Zvicrës, ai u tregua lojtar i futbollit vulgar. Është e pakuptueshme që trajneri Tite nuk i dha Dugllas Kostanjë minutë të vetme aktivizim". Ndërsa media tjetër braziliiane "Globoesport" e ka vlerësuar paraqitjen e futbollistit të PSG-së me notën 5.5. "Abuzoi shumë me shfaqjet individuale dhe ishte larg nga niveli që tregoi në dy ndeshjet e fundit. Ai u shfaq vetëm në fund të lojës me një goditje me kokë", shkruhej në vlerësimin e "Globoesport".



Pastore, afër kalimit te Roma

ROMË, 18 QERSHOR - Raportohet se Roma është shumë afër të nënshkruajë me Javier Pastoren. Mesfushori pritet të kalojë te klubi i kryeqytetit italian nga Paris Saint Germaini për 25 milionë euro. Kampionët e Ligës 1 duhet të mbledhin 60 milionë euro deri në fund të muajit që të jenë në rregull

me Fair Play. Sipas "Tuttomercatoweb", argjentinasi do të jetë shtija e dytë e klubit nga Parisi, marrëveshja do të mbyllet 20 milionë euro, plus pesë milionë në formë të bonuseve. 28-vjeçari pritet të nënshkruajë kontratë katërvjeçare, ku pritet të fitojë rreth katër milionë euro në sezon.



Vendoset busti i ri i Ronaldos në aeroportin e Madeiras

MADEIRA, 18 QERSHOR - Aeroporti i Madeiras, që mban emrin e Cristiano Ronaldos, tashmë ka një bust të ri. Me nënshkrimin e familjes, këtë javë ka ndryshuar

skulptura që ishte vendosur vitin e kaluar, pasi u bë virale për shkak të mosngjashmërisë së madhe me fytyrën e Cristianos. Skulptori i veprës,

Emanuel Santos, mori shumë kritika për bustin e parë dhe kishte vendosur të krijojë një të ri që e përfundoi në muajin mars.

Dështimet e Gjermanisë dhe të Brazilit, komenti i Mourinhos

MOSKË, 18 QERSHOR - Gjermania dhe Brazili dështuan të bëjnë një nisje të mirë të Botërorit të dielën. Por trajneri i njohur Jose Mourinho, duke komentuar këtë ndeshje, ka pohuar

se kjo ishte një ditë e mrekulueshme për futbollin. "Ndoshta u bënë mirë të ulen me këmbë në tokë", ka thënë ai për "Russia Today. Megjithatë, portugezi nuk

beson se këto dy ekipe do të ndikohen nga nisja. "Do të kualifikohen dhe ekipet më të mira do të dalin në fazën tjetër. Mendoj se ata e dinë se do të përmirësohen. Ndoshta është

mirë që tifozët e tyre të qetësohen", ka thënë Mourinho. Brazili do të aluajë me Kosta Rikën të premtën, kurse Gjermania do përballet me Suedinë të shtunën.



Autor : GAZMEND MORINA	AKTORJA & KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO 1	PËRSHATJE	THEMBRA E KËPUCËS	TË FTOHTË I MADH, I THATË E ME NGRICË (shq.)	JOD, ALUMIN	KOMPOZITORI KOCI	EPOKA ERE	KUNDËRSHT- AR I BOLSHEVIZMIT RUS	MIZORI; GJAKATARI	DY BASHKË- TINGËLLORE	TRAJNERI ITALIAN SAKI	FILLOJ	1							
FATKEQËSIA E MADHE, KOBI							PLLAKË E VENDOSUR NË APARATE TË NDRYSHME, KU RIPRODH- OHEN SINJALE													
QË LARGOHET SHPEJT NGA NDONJË RREZIK							VEPRIMTARI RAMABAJA SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE													
NDARJE E VOGËL ADM- INISTRATIVE SHALË PREJ DRURI ME DY KAPTEJ											IDRIZ SEFERI NORA ISTREFI									
					GABZHERR, GURMAZ AKTORI YNË MUÇAJ (shq.)								QË KA TË BEJË ME NERVAT							
"ROTTERDAM"			INDIUM E PËRZIER; E TRAZUAR			RAVENA ISH FUTBOLLISTI ITALIAN BAGJO		KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (shqip.) NOTË MUZIKORE												
MENDIM				JETA PA TRAZIME (libr.) STREHIMI POLITIK							VENDËSE, RRËNJËSE (sh.shq.)	ZANORE INDIANA, OHAJO								
PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE									AJËR (huaj) I ZË ME DORË				DUKAT	BASHKËBAN- UES GJATË KOHËS SË STUDIMEVE	REGJISORJA SHQIPTARE GJONI	FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO ... (MILAN)	QYTET I MADH DHE KLUB FUTBOLLI NË ITALI			
FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit greke)								RISI, PËRTËRITJE I DËRGUARI SPECIAL PËR ZGJIDHJEN E NJË KONFLIKTI												
FLORIDA		ARKIVI I FILMAVE NOBELISTI YNË FERID									KËNGËTARJA HUTA BABAIT									
EPOKA ERE	GAZETARI ... QORRAJ (shq.) THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)					ERBIUM; TANTAL	EMËR YNI MASHKULLI AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 2						DRITËSHKU- RTËR SHTIMI NATYROR I POPULLSISË							
PAKO NJERI I PABESË E TRADHTAR (fig. keq.)					SKUADËR (sh.shq.) ZANORE							LLOJ KAFFEJE SHPREHI E KEQE; HUQ					ONTARIO KËNGËTARJA SHQIPTARE KARAVELLO			
				KËNGËTARI ITALIAN RAMAZOTTI ANDORA					QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI BIMË QË PËRDORËT SI USHQIM					DY BASHKË- TINGËLLORE LËNDË MËSIMORE						
NJËSI MATJEJE (E GJATËSISË, E PESHËS, E VËLLIMIT (shq.)					MJET I THJESHË LUNDRIMI KASTRIOT TUSHA				VITI I RI KINEZ (pashq.) SHPEND UJI SHTEGTAR				DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE NAPOLI, INTER							
LETËR E FORTË NË BIXHOZ				ZIFT ZANORE							SANACION, PËRMIRËSIM QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT								SHEGË	
KADE E MADHE DRURI, QË SHËRBEN PËR TË MBA- JTUR VERË (sh.shq.)					ELEMENT KIMIK MIKROBI							PORT DETAR FJALË POHUESE								
2								ZEZAKU, I ZIU DIJETAR FETAR MYSLIMAN					RAFINERIA E ZAGREBIT PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA							
										FUTBOLLISTI FANÇESKO (ROMA) QË KA TË BËJË ME FSHATIN			AUTOTARGA E TIRANËS SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA ...							
												EMËR YNI FEMRE POETI VINCA							BITUMI NATYROR	
								LUTJE ME TË CILËN PRIFTI SHPREH DISA DËSHIRA (sh.shq.) KËNGËTARJA ... BYTYQI					BASHKËTIN- GËLLORE VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE; SHTEG							
											VEGËL MUZIKORE; KITARË NAIM ABAZI									
							KRYEQYTETI I JORDANISË JEMENI						PRINC ARAB ZANORE							
							FJALË E RËNDË, E PAHIJSHME (turq.)									MIMOZA AHMETI				



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
Одељење за здравство и социјалну заштиту
КОМУНА Е ГРАЧАНИЦËС
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Грачица/ Graçanicë

